



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 528 Prot.

Tiranë, më datë 07.11.2024

VENDIM

Nr. 464, datë 07.11.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 07.11.2024:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raporti i vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit “Resort turistik dhe rezidencial “Village Square” 1 dhe 6 kate mbi tokë dhe 1-2 kate nëntokë”, në pronat me nr. pasurie 1/118, 1/129, 1/120, 1/130, 1/141, 1/142, 1/122, 1/145, 1/152, 1/156, 1/146-1, 1/146-2, 1/147/1, 147/2, 1/154, 1/157, 1/157-1, 1/158, 1/149, 1/155/3, 155/4, 1/203, Zona Kadastrale 1739, me vendndodhje në Dhërmi, Bashkia Himarë, me zhvillues subjekti “Seaside Costruction” sh.p.k.;
 2. Investitori duhet të lidhë akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve për projektin “Resort turistik dhe rezidencial “Village Square” 1 dhe 6 kate mbi tokë dhe 1-2 kate nëntokë”, në pronat me nr. pasurie 1/118, 1/129, 1/120, 1/130, 1/141, 1/142, 1/122, 1/145, 1/152, 1/156, 1/146-1, 1/146-2, 1/147/1, 147/2, 1/154, 1/157, 1/157-1, 1/158, 1/149, 1/155/3, 155/4, 1/203, Zona Kadastrale 1739”, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e më pas subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
 3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
 4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Sokol ISMAILI



KRYETAR
Blendi GONXHJA